



Republika e Kosovës
Republika Kosova/ Republic of Kosovo
Këshilli Prokurorial i Kosovës/ Tužilački Savet Kosova/Kosovo Prosecutorial Council

KPK/Nr. 31 /2024
Datë: 15 janar 2024

Këshilli Prokurorial i Kosovës, në bazë të nenit 7 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-056 për Këshillin Prokurorial të Kosovës, dhe nenit 31 paragrafi 2 të Ligjit NR. 08/L-167 për Prokurorin e Shtetit, në takimin e mbajtur më datë 15 janar 2024, mori këtë:

VENDIM

- I. Znj. Elza Bajrami, prokurore në Departament të Përgjithshëm të Prokurorisë Themelore në Prishtinë, caktohet Zëvendës-Kryeprokurore e Prokurorisë Themelore në Prishtinë.
- II. Znj. Elza Bajrami do ta ushtrojë këtë pozitë me mandat katër (4) vjeçar nga data 15 janar 2024.
- III. Znj. Elza Bajrami ngarkohet me lëndë ashtu siç përcaktohet në legjislacionin në fuqi.
- IV. Vendimi hyn në fuqi ditën e miratimit nga Këshilli Prokurorial i Kosovës.

Arsyetimi

Këshilli Prokurorial i Kosovës, me datë 4 janar 2024 ka kërkuar nga Kryeprokurori i Prokurorisë Themelore në Prishtinë, propozimin për caktimin e Zëvendës-Kryeprokurorit të kësaj prokurorie. Me datë 10 janar 2024 Këshilli, ka pranuar propozimin e Kryeprokurorit, meqë rast i njëjti ka kërkuar që prokurorja, znj. Elza Bajrami, e cila njëherit është propozuar si Zëvendës-Kryeprokurore e kësaj prokurorie, të shkarkohet me lëndë.

Këshilli Prokurorial i Kosovës ka vendosur që ta caktojë znj. Elza Bajrami Zëvendës-Kryeprokurore me mandat 4 vjeçar, ndërsa për pjesën tjetër të kërkesës për shkarkimin me lëndë, të njëjtën e ka refuzuar për shkak të mungesës së bazës ligjore.

Andaj bazuar në të lartcekurat vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Jetish Maloku
Kryesues i Këshillit Prokurorial të Kosovës

T'i dërgohet:

- Znj. Elza Bajrami, prokurore në PTH Prishtinë;
- Kryeprokurorit të PTH Prishtinë;
- Sekretariatit dhe NJSHPP-së;
- Arkivit të KPK-së.